

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA E POLITIKËS MONETARE DHE E HULUMTIMIT



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Rishikimi i gjendjes aktuale

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Rishikimi i gjendjes aktuale – ndikimi ndaj politikës monetare

Rishikimi i gjendjes aktuale synon të japë pasqyrë të të dhënave më të fundit makroekonomike (prill – qershor 2024) dhe krahasim me projeksionet më të fundit makroekonomike (prill 2024). Kjo do të vërtetojë se si gjendja aktuale e ekonomisë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të projeksioneve. Rishikimi është përqendruar në ndryshimet e supozimeve dhe të realizimeve të jashtme në variablat e brendshme dhe si janë pasqyruar këto ndryshime në mjedisin e drejtimit të politikës monetare.

Projeksionet më të fundit të organizatave ndërkombëtare¹ për rritjen ekonomike globale për periudhën 2024-2025 janë të ngjashme me muajin prill. Rreziqet që lidhen me rritjen globale në afat të mesëm vlerësohen ende si të balancuara. Megjithatë, në terma afatshkurtër, perceptohen rreziqe të caktuara në rënie që lidhen me inercinë e inflacionit, për shkak të ngadalësimit më të ngadaltë të çmimeve të shërbimeve dhe tensioneve gjeopolitike. Domethënë, inflacioni më i lartë rrit mundësinë e mbajtjes së normave të larta të interesit për kohë më të gjatë, gjë që rrit rreziqet e jashtme, fiskale dhe financiare. Rreziqe të tjera përfshijnë tarifa të ndryshme tregtare dhe ndryshime në politika me efekt të pafavorshëm në tregti. Në të kundërt, zbatimi më i shpejtë i reformave makrostrukturore do të ketë një efekt pozitiv në ofertën, produktivitetin dhe rritjen.

Shikuar përmes treguesve të veçantë sasiorë të mjedisit të jashtëm domethënës për ekonominë maqedonase, vlerësimet për rritjen e **kërkesës së huaj efektive** për periudhën 2024-2025 janë të pandryshuara në krahasim me projeksionet e prillit dhe janë bërë korrigjime të vogla për **inflacionin e jashtëm efektiv** (në rënie për vitin 2024 dhe në rritje për vitin 2025). Në kursin euro-dollarë janë bërë korrigjime në rritje në të dy vitet e projeksionit. Rishikimet në **çmimet botërore të produkteve primare** janë në drejtime të ndryshme, me rishikime në rritje të çmimit të naftës dhe metaleve në periudhën 2024 - 2025 dhe në rënie të çmimeve të drithërave. Në të njëjtën kohë, pritet që çmimet të bien kryesisht në vitin 2024 dhe rritja e tyre në vitin 2025. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të lëndëve të para janë jashtëzakonisht të paqëndrueshme dhe të ndikuara fuqishëm nga zhvillimet që lidhen me luftën në Ukrainë dhe konfliktin ushtarak në Lindjen e Mesme, gjë që krijon pasiguri të madhe për dinamikën dhe efektet e tyre të ardhshme në ekonominë globale dhe të brendshme.

Përsa i përket **normës së interesit të huaj EURIBOR** me maturim njëmuajor, vlerësimet për vitet 2024 dhe 2025 janë rishikuar lehtësisht në rritje, në pajtim me pritshmëritë për ulje më të moderuar të normave të interesit nga BQE-ja në periudhën në vijim. Kështu, pas uljes së muajit qershor, BQE-ja mbajti të pandryshuara normat e interesit në mbledhjen e korrikut, duke vlerësuar se inflacioni në Eurozonë është ende i lartë, me presione të pranishme nga çmimet e shërbimeve dhe pritet afim me nivelin e synuar në gjysmën e dytë të vitit 2025.

Treguesit më të fundit nga ekonomia vendase flasin për pasqyrë makroekonomike që është më së shumti në pajtim me parashikimet e muajit prill. Në tremujorin e parë të vitit 2024, **rritja reale vjetore e PBB-së është 1,2%** dhe është në pajtim me pritjet për përsheptimin e rritjes në tremujorin e parë, por është pak më e moderuar se ajo e vlerësuar gjatë ciklit të projeksioneve të prillit (1,7%). Të dhënat me frekuencë të lartë për periudhën prill-maj 2024 tregojnë për një përsheptim të mëtejshëm të rritjes nën ndikimin e arritjeve në sektorin e shërbimeve, i cili është në pajtim edhe me parashikimet për tremujorin e dytë.

¹ Sipas Raportit të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Rishikimi Ekonomik Botëror" korrik 2024.

Kështu, sektori i ndërtimit ka shënuar një rritje reale vjetore dukshëm më të lartë, si dhe një rritje e lehtë e normës reale të rritjes është vërejtur edhe në hotelieri dhe turizëm. Gjithashtu, qarkullimi në tregti shënoi rënie reale dukshëm më të dobët në bazë vjetore, por rënia e prodhimit industrial po thellohet. Gjithashtu, rritja solide e pagave dhe pensioneve pritet të kontribuojë në rritjen e të ardhurave të disponueshme të popullsisë edhe në tremujorin e dytë, në pajtim me pritjet e muajit prill. **Në qershor 2024, norma vjetore e inflacionit u ngadalësua më shumë dhe u ul në 3,2%** (4,5% në muajin paraardhës). **Pritjet e konsumatorëve** të dhëna në anketat e qershorit për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë ende në drejtim të uljes së çmimeve në periudhën e ardhshme. **Hapësira në raport me inflacionin në Eurozonë**, sipas të dhënave të qershorit, shënoi një ngushtim të ndjeshëm. Rishikimet në lidhje me çmimet e importit janë kryesisht në rënie, por pasiguria dhe rreziqet rritëse që lidhen me dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa për shkak të tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike janë ende të pranishme.

Rezervat valutore në fund të tremujorit të dytë 2024 arrijnë në 4.337,5 milionë euro. Nga analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore, rezulton se ato vazhdojnë të mbahen në zonën e sigurt. Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në muajt prill dhe maj 2024 tregojnë për një deficit tregtar për tremujorin e dytë të vitit, i cili është në nivelin e pritur sipas projeksionit të prillit. Të dhënat për operacionet e këmbimit për tremujorin e dytë të 2024 tregojnë për flukse të qëndrueshme neto nga transfertat private, por pak më të ulëta se sa pritej për tremujorin e dytë sipas projeksionit të prillit.


Sa i përket **lëvizjeve në sektorin monetar**, numri i përgjithshëm i **depozitave** në qershor 2024 është më i lartë me 7,6% në bazë vjetore, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e dytë prej 9,2% sipas projeksionit të prillit. **Kreditë e përgjithshme** për sektorin privat në qershor 2024 janë më të lartë me 6,4%, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e dytë prej 6,0% sipas projeksionit të prillit. Rritja e kredive të reja të miratuara ka ardhur në rritje që nga fillimi i vitit, si rezultat i të dy sektorëve (ndërmarrjeve dhe amvisërive). Konkretisht, shumica e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, duke filluar nga muaji maj, mesatarisht ka shënuar rritje vjetore.

Në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar - maj 2024 është realizuar deficit prej 20.545 milionë denarë ose 61,3% nga deficiti i planifikuar për vitin 2024. Deficiti buxhetor financohet nga huamarrja neto e shtetit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, me akumulimin e depozitave të shtetit në Bankën Popullore.

Lëvizjet dhe pikët për treguesit kryesorë makroekonomikë janë përgjithësisht brenda pritshmërive nga parashikimet e fundit. Norma vjetore e inflacionit u ngadalësua ndjeshëm në muajin qershor, kryesisht tek ushqimet dhe komponentët bazë, por ende është mbi mesataren historike. Pritjet inflacioniste janë ende të favorshme, por nga rezultatet e sondazheve të Komisionit European të qershorit, në të cilat mbizotërojnë pritjet për ulje çmimesh në periudhën e ardhshme. Përsa i përket çmimeve të produkteve primare në bursa, ato janë ende mjaft të ndryshueshme, ashtu si edhe parashikimet për lëvizjen e tyre në periudhën e ardhshme, dhe konteksti i paqëndrueshëm gjeopolitik vijon të krijojë pasiguri dhe rreziqe. Rritja e ekonomisë së brendshme në tremujorin e parë të vitit 2024 u përshpejtua lehtësisht, por është nën nivelin e parashikuar dhe të dhënat e disponueshme për tremujorin e dytë 2024 janë aktualisht në pajtim me pritjet për dinamikë pak më të fortë të rritjes së aktivitetit ekonomik. Lëvizjet në tregun valutor janë ende të favorshme, me fluks të mëtejshëm solid të valutës në tregun valutor. Potenciali depozitues i bankave është solid, ndonëse ritmi i rritjes në fund të qershorit është nën pritshmëritë, me rritje kreditore pak më të fortë se sa ishte parashikuar.

Tregues të përgjegjedhur makroekonomik/ 1								2023																2024									
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korrr.	gush.	sht.	tr.3	tet.	nën.	dhj.	tr.4	2023	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	
I. Treguesit e sektorit real																																	
Produkti bruto i brendshëm (ritija reale vjetore) ^{/2}	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5	2.2				1.4				0.9				1.0				0.9	1.0				1.2					
Prodhimi industrial ^{/3}																																	
norma e ndryshimit (vjetore)	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	-0.2	-2.3	1.0	1.2	0.1	-1.6	6.1	3.7	2.7	-1.7	-5.1	4.5	-0.6	9.9	-2.4	-5.8	0.4	0.6	2.9	0.3	-10.5	-3.0	-1.2	-13.2			
norma mesatare kumulative	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	-0.2	-2.3	-0.5	0.1	0.1	-0.3	1.0	1.5	1.5	1.0	0.3	0.8	0.8	1.7	1.3	0.6	0.6	0.6	2.9	1.5	-3.0	-3.0	-2.6	-4.9			
Inflacioni ^{/4}																																	
CPI inflacioni (vjetore) ^{/5}	-0.2	2.4	0.9	0.4	2.3	4.9	18.7	17.1	16.7	14.7	16.1	13.0	11.3	9.3	11.2	8.4	8.3	6.6	7.7	3.5	3.1	3.6	3.4	3.6	3.2	3.0	4.0	3.4	4.0	4.5	3.2	3.9	
CPI inflacioni (mesatare kumulative)	-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	14.2	17.1	16.9	16.1	16.1	15.3	14.5	13.6	13.6	12.8	12.2	11.5	11.5	10.7	9.9	9.4	9.4	9.4	3.2	3.1	3.4	3.4	3.6	3.8	3.7	3.7	
Inflacioni bazë (mesatare kumulative)	1.3	2.3	1.5	0.5	0.9	2.4	7.1	10.8	10.6	10.2	10.2	10.2	9.9	9.6	9.6	9.3	9.0	8.7	8.7	8.5	8.2	8.0	8.0	8.0	5.1	4.9	5.0	5.0	4.7	4.9	4.9	4.9	
Inflacioni bazë (vjetore) ^{/5}	1.0	2.8	1.4	-0.3	1.9	2.9	10.8	10.8	10.4	9.5	10.2	10.1	8.9	8.2	9.1	7.4	7.1	6.3	7.0	6.2	6.2	5.4	5.9	5.5	5.1	4.7	5.1	5.0	4.1	5.5	4.7	4.8	
Fuqia punëtore																																	
Norma e papunësisë ^{/11}	23.7	22.4	20.7	17.3	16.4	15.7	14.4				13.3				13.1				12.8				13.0	13.1				12.9					
II. Treguesit e sektorit fiskal (Buxheti qendror dhe Buxheti i fondeve)																																	
Gjithsej të hyrat buxhetore	169,356	179,673	188,505	203,822	189,554	218,021	243,085	19,268	18,749	27,991	66,009	21,207	22,294	21,639	65,140	22,594	22,005	21,728	66,326	26,865	24,128	28,677	79,669	277,144	21,447	23,193	24,777	69,417	28,891	23,739	22,257	74,887	
Gjithsej shpenzimet buxhetore	185,407	196,561	200,071	217,445	243,421	256,906	278,596	20,681	23,003	25,849	69,533	30,183	24,814	30,202	85,199	26,057	22,007	22,249	70,313	24,370	27,518	41,633	93,521	318,566	26,947	28,897	28,240	84,084	28,633	31,380	24,065	84,078	
Bilanci buxhetor (para të gatshme bazë)	-16,051	-16,888	-11,566	-13,623	-53,867	-38,885	-35,511	-1,413	-4,254	2,142	-3,524	-8,976	-2,520	-8,563	-20,059	-3,464	-3	-521	-3,987	2,495	-3,390	-12,956	-13,852	-41,422	-5,500	-5,704	-3,463	-14,667	259	-7,641	-1,808	-9,191	
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{/1}	-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-0.2	-0.5	0.2	-0.4	-1.0	-0.3	-1.0	-2.3	-0.4	0.0	-0.1	-0.5	0.3	-0.4	-1.5	-1.6	-4.8	-0.6	-0.6	-0.4	-1.6	0.0	-0.9	-0.2	-1.0	
III. Treguesit financiar ^{/6}																																	
Paraja e gjerë (M4), norma vjetore e rritjes	6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	5.1	4.5	5.7	6.9	6.9	8.6	10.5	11.4	11.4	10.6	9.8	8.8	8.8	8.3	7.4	8.7	8.7	8.7	10.0	9.5	9.5	9.5	9.5	9.3	8.5	7.6	7.6
Totali i kredive, norma vjetore e rritjes	-0.1	5.4	7.3	6.0	4.7	8.0	9.4	8.5	7.7	6.6	6.6	6.3	6.5	6.5	6.5	5.8	6.4	5.8	5.8	5.3	5.2	5.1	5.1	5.1	5.7	6.5	6.1	6.1	6.8	6.8	6.4	6.4	
Totali i kredive të popullsisë	7.0	9.2	10.3	10.5	8.0	7.8	7.3	7.4	7.2	6.8	6.8	6.7	6.5	6.4	6.4	6.4	6.7	6.4	6.4	6.3	6.5	6.7	6.7	6.7	6.9	7.2	6.8	6.8	7.0	7.0	7.1	7.1	
Totali i kredive të ndërmarrjeve	-5.3	2.3	4.5	1.9	1.1	8.7	11.5	9.7	8.2	6.2	6.2	5.9	6.5	6.5	6.5	5.0	5.8	5.1	5.1	4.1	3.8	3.3	3.3	3.3	4.3	5.9	5.4	5.4	6.6	6.4	5.8	5.8	
Totali i depozitave (me para të depozituara), norma vjetore e rritjes ^{/7}	6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	4.9	4.5	5.9	6.9	6.9	8.7	10.7	11.6	11.6	11.2	10.2	9.0	9.0	8.3	7.4	9.1	9.1	9.1	10.3	9.6	9.6	9.6	9.6	8.6	7.6	7.6	
Totali i depozitave të popullsisë	2.5	6.1	9.5	7.9	4.6	7.1	5.8	5.9	6.3	8.4	8.4	8.3	8.7	8.8	8.8	8.4	7.0	6.8	6.8	6.8	7.1	7.9	7.9	7.9	7.8	8.6	8.7	8.7	10.8	10.2	8.9	8.9	
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	13.4	2.1	9.5	14.6	10.1	11.6	3.7	2.6	5.7	5.9	5.9	12.0	17.8	19.7	19.7	18.9	19.0	15.7	15.7	14.1	9.8	13.2	13.2	13.2	15.9	12.3	12.2	12.2	8.0	5.0	4.7	4.7	
Normat e interesit ^{/8}																																	
Norma e interesit e bonovo të bankës qendore (në fund të muajit/tremujorit/vitit)	3.75	3.25	2.50	2.25	1.50	1.25	4.75	4.75	5.25	5.50	5.50	5.50	5.75	6.00	6.00	6.00	6.15	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	
Normat e interesit të huadhenies																																	
në denarë	7.0	6.6	6.1	5.6	5.2	4.9	4.6	5.1	5.1	5.2	5.1	5.2	5.2	5.3	5.2	5.6	5.7	5.7	5.7	5.8	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9		
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzi)	5.7	5.3	4.9	4.6	4.3	4.1	4.0	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	5.3	5.3	5.2	5.3	5.2	5.2	5.1	5.2	5.1	5.1	5.1	5.0	5.1	5.0	5.0	5.0		
Normat e interesit të depozitave																																	
në denarë	2.5	2.2	2.0	1.9	1.5	1.2	1.1	1.3	1.4	1.5	1.4	1.6	1.6	1.8	1.7	1.9	2.0	2.0	2.0	2.1	2.2	2.3	2.2	1.8	2.2	2.3	2.3	2.2	2.3	2.3	2.3		
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzi)	1.0	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.4	0.6	0.7	0.8	0.7	0.9	0.9	1.0	0.9	1.1	1.2	1.2	1.2	1.3	1.3	1.4	1.3	1.0	1.3	1.3	1.4	1.4	1.4	1.5	1.5		
IV. Treguesit e sektorit të jashtëm																																	
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në milionë euro)	-252.5	-78.3	22.4	-334.7	-318.0	-329.0	-797.4	-17.0	18.4	91.4	92.8	-94.6	22.6	-52.9	-124.9	129.2	28.3	81.7	239.2	3.5	1.7	-117.0	-111.7	95.3	-38.6	-82.2	-64.1	-185.0	-1.3				
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)	-2.6	-0.8	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	-0.1	0.1	0.7	0.7	-0.7	0.2	-0.4	-0.9	0.9	0.2	0.6	1.8	0.0	0.0	-0.9	-0.8	0.7	-0.3	-0.6	-0.4	-1.3					
Bilanci tregtar (në milionë euro) ^{/9}	-1,786.2	-1,816.2	-1,811.4	-2,007.7	-1,816.6	-2,715.7	-3,829.7	-228.1	-196.1	-209.3	-633.5	-195.6	-215.2	-241.9	-652.6	-201.4	-309.6	-210.3	-721.3	-277.6	-239.2	-301.5	-818.2	-2825.7	-249.8	-287.1	-270.7	-807.6	-305.8	-286.5			
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-18.0	-18.1	-16.9	-17.8	-16.7	-22.9	-29.4	-1.7	-1.4	-1.5	-4.6	-1.4	-1.6	-1.8	-4.8	-1.5	-2.3	-1.5	-5.3	-2.0	-1.8	-2.2	-6.0	-20.7	-1.7	-2.0	-1.9	-5.5	-2.1	-2.0			
Importi (në milionë euro)	-6,176.5	-6,834.9	-7,676.3	-8,441.0	-7,594.5	-9,638.3	-12,130.8	-849.4	-915.0	-995.2	-2,759.6	-857.3	-985.1	-936.0	-2,778.3	-897.4	-864.8	-947.8	-2,710.0	-983.2	-957.5	-959.8	-2,900.5	-11,148.5	-800.5	-944.3	-992.7	-2,737.6	-1,018.5	-889.9			
Eksporti (në milionë euro)	4,390.3	5,018.7	5,872.4	6,433.3	5,777.9	6,922.6	8,301.2	621.3	718.9	785.9	2,126.1	661.7	769.9	694.1	2,125.7	696.0	555.2	737.4	1,988.7	705.6	718.4	658.4	2,082.3	8322.8	550.6	657.3	722.1	1,930.0	712.7	603.4			
Norma e rritjes së importit (vjetore)	6.5	10.7	12.3	10.0	-10.0	26.9	25.9	5.0	-6.9	-5.1	-2.9	-21.2	-6.2	-6.5	-11.5	-4.5	-11.8	-14.2	-10.4	-11.3	-4.4	-5.4	-7.2	-8.1	-5.8	3.2	-0.2	-0.8	18.8	-9.7			
Norma e rritjes së eksportit (vjetore)	7.4	14.3	17.0	9.6	-10.0	19.8	19.9	13.8	7.2	8.7	9.6	-3.1	4.8	-6.4	-1.5	3.9	-11.8	-3.0	-3.5	-8.9	0.1	1.3	-2.8	0.3	-11.4	-8.6	-8.1	-9.2	7.7	-21.6			
Investimet e huaja direkte (në milionë euro)	316.9	179.9	603.7	363.3	154.7	-387.5	-654.2	-18.1	-62.9	-62.2	-143.3	-71.7	-43.7	-7.0	-122.4	-12.4	-45.3	6.6	-51.2	-40.4	-61.9	-103.9	-206.2	-523.1	-64.3	-64.2	-107.4	-235.9					
Borxhi i jashtëm																																	
Borxhi i jashtëm bruto (në milionë euro)	7,216.6	7,372.5	7,843.7	8,154.4	8,536.1	9,576.6	10,790.0				11,057.2				11,393.0				11,076.2				11,462.7	11,462.7				11,789.4					
sektori publik	3,445.3	3,461.8	3,756.2	3,836.6	4,301.5	4,802.0	5,206.8				5,394.7				5,545.6				5,238.1				5,578.5	5,578.5				5,826.0					


Kërkesa e huaj efektive
(ndryshime vjetore në %)



Vlerësimet për **kërkesën e huaj** janë të pandryshuara krahasuar me muajin prill për të gjithë periudhën e projeksioneve.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Inflacioni i huaj efektiv
(ndryshime vjetore në %)




Për sa i përket **inflacionit të huaj efektiv**, vlerësimi për vitin aktual është pak më i ulët se ai i parashikuar në muajin prill...

...ndërsa për vitin 2025 korrigjimet janë lehtësisht në rritje, por ende pritet ngadalësim i tij.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kursi euro/USD-dollar




Në **kursin e këmbimit euro-dollar**, rishikimet janë në rritje, në pajtim me pritshmëritë për lehtësim më të ngadalhtë monetar nga FED-i dhe vlerësimet për performancë më të mirë ekonomike në Shtetet e Bashkuara në krahasim me Eurozonën.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Nafta "brent"

(mesatarja tremujore, euro/fuçi)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Korrigjimet e çmimeve të metaleve dhe naftës për vitet 2024 dhe 2025 janë në rritje, ndërsa çmimet e produkteve ushqimore janë në rënie...

...ku rishikimi i çmimit të naftës është reflektim i tensioneve të rritura gjeopolitike në Lindjen e Mesme dhe pritjeve për rritje të kërkesës, ndërsa në çmimet e bakrit dhe nikelit është rezultat i pritjeve të investitorëve për rritje të kërkesës, me prodhimin e reduktuar....

...ndërsa korrigjimi në rënie i çmimeve të misrit dhe grurit janë rezultat i pritjeve për rritje të prodhimit.

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro


(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Çmimet e grurit dhe misrit në euro

(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Euribor-i njëmuor
(mesatarja tremujore, në %)



Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Me EURIBOR-in njëmuor, u bënë korrigjime të vogla në rritje për të gjithë periudhën e projeksionit, në pajtim me pritshmëritë për ulje më të moderuar të normave të interesit nga BQE-ja në periudhën në vijim.

Indeksi i stresit financiar




Burimi: "Zyra për Hulumtime Financiare në kuadër të Këshillit për mbikëqyrje të stabilitetit financiar të SHBA'së".

Treguesi i stresit financiar global² dhe më tej tregon për ndryshim të ulët në tregjet financiare.

² Indeksi OFR FSI mat stresin financiar sistematik - shqetësimet në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 variabla të tregut financiar, të agreguara në pesë kategori treguesish: kredia, vlerësimi i kapitalit, financimi, aktivet e sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e indeksit në një ditë të caktuar përfaqëson një nivel mesatar të ponderuar të çdo variabli të vëzhguar në treg atë ditë, në raport me vlerën e tij historike, me indeksin pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit

(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.


Në qershor 2024, çmimet e konsumit të brendshëm shënuan rënie të lehtë prej 0,3% në bazë mujore (nga 0,9% në maj), pasi çmimet e ushqimeve dhe energjisë ranë.

Çmimet e ushqimeve u ulën me 0,5%, pothuajse tërësisht për shkak të rënies së çmimeve të perimeve (kryesisht perimeve të freskëta, të ndikuar nga stina). Nga ana tjetër, shumica e kategorive të tjera shënuan rritje, duke kompensuar pjesërisht efektin e uljes së çmimeve të perimeve.

Çmimet e energjisë shënuan rënie mujore prej 0,9%, kryesisht si pasojë e uljes së çmimeve të derivateve të naftës, në linjë me lëvizjet e bursave botërore.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë


(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Inflacioni bazë në bazë mujore nuk ka ndryshuar, pra efekti i uljes së çmimeve të transportit ajror është kompensuar nga rritja e çmimeve të pijeve joalkoolike dhe produkteve të higjienës personale.

Norma vjetore e inflacionit në qershor u ngadalësua në 3,2% (4,5% në maj), e cila vjen si pasojë e rritjes së ngadaltë të çmimeve të tre kategorive, kryesisht të ushqimeve.


Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p)

Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Hapësira në raport me inflacionin në Eurozonë shënoi një rënie të ndjeshme në muajin qershor³, në kushtet e një ngadalësimi më të madh të inflacionit të brendshëm sesa inflacioni në Eurozonë.

³ Bazuar në indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit.


Diferenca ndërmjet inflacionit vendas dhe inflacionit në Eurozonë (në p.p.)



Burimi: Eurostat.

Pritjet e konsumatorëve⁴ të dhëna në anketat e qershorit për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme ende tregojnë ulje të tyre.


Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Sa i përket **sektorit korporativ**⁵, në muajin qershor, pritjet për lëvizje të çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të ulëta në të gjithë sektorët.

Parashikimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve për inflacionin në 3 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)




Burimi: Komisioni Evropian.

Norma e inflacionit vjetor të realizuar në muajin qershor është brenda normës së parashikuar nga cikli i projeksioneve të prillit.

⁴ Anketa e Komisioni Evropian për optimizmin e konsumatorëve në qershor 2024, bazuar në pyetjen "pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm".

⁵ Anketa për trendencat e biznesit të Komisionit Evropian në industri, shitje me pakicë, ndërtim dhe sektorin e shërbimeve.

Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimeve dhe pijeve joalkolike (indeks, 2015=100)




* Çmimet e huaja efektive të ushqimeve paraqesin shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: EShS-ja, Eurostat-i dhe llogaritje të BPRMV-së.

Rishikimet e **lëvizjeve të pritshme të supozimeve të inputeve të jashtme** në projeksionin e inflacionit (çmimet e importit) për vitin 2024 janë kryesisht në drejtim rënës, me përjashtim të çmimeve të naftës, ku ka një rishikim në rritje. Në të njëjtën kohë, ka ende pasiguri dhe rreziqe të mëdha për dinamikën e ardhshme të produkteve primare.

Paga mesatare e paguar (normat vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

Në prill 2024, rritja vjetore e **pagës mesatare nominale neto** u ngadalësua më shumë dhe arriti në 13,7% (16% në muajin paraardhës),...

...me një rënie vjetore të pagave në veprimtarinë "veprimtari financiare dhe sigurime" dhe një ngadalësim më të madh të rritjes në veprimtarinë "furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar", "veprimtaritë e shërbimit administrativ dhe ndihmës", "objektet e akomodimit dhe aktivitete të shërbimit të ushqimit", "art, argëtim dhe rekreacion" dhe "aktivitete të shëndetit dhe mbrojtjes sociale".

... dhe të ngjashme janë lëvizjet e **pagës reale neto**, rritja e së cilës gjithashtu ngadalësohet në muajin prill.


Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve
(normat nominale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Rritja e pagave nominale dhe reale vjetore e arritur në prill 2024 është aktualisht nën normat e pritura për tremujorin e dytë brenda projeksonit të prillit.

Treguesi i besueshmërisë ekonomike dhe PBB-ja




Burimi: EShS-ja dhe Komisioni Evropian.

Të dhënat e frekuencës së lartë në kahun e ofertës që janë të disponueshme për periudhën prill-maj 2024 tregojnë kryesisht për lëvizje më të favorshme për momentin.

Rezultatet nga anketat hulumtuese për tremujorin e dytë të vitit 2024, mesatarisht tregojnë për perceptime më të favorshme në raport me tremujorin e dytë të vitit 2023, si dhe në raport me tremujorin paraardhës⁶.

Veprimtaritë ekonomike
(ndryshimet reale vjetore, në %)



* Mesatare e thjeshtë e normave të ndryshimit vjetorë të mënyrave të transportit dhe telekomunikacionit.
Burimi: EShS-ja dhe llogaritje të BPRMIV-së.

Në muajin prill, **ndërtimi** shënoi rritje reale të lartë në bazë vjetore, dukshëm më e lartë se rritja në tremujorin e kaluar...

... si rezultat i rritjes në tre kategoritë (ndërtim i ulët, ndërtim i lartë dhe punime të specializuara ndërtimi⁷).

Hotelieria në muajin prill shënoi gjithashtu një rritje reale vjetore më të fortë, me rritje të mëtejshme solide të numrit të turistëve dhe qëndrimeve gjatë natës.

⁶ I referohet anketave të kryera nga Komisioni Evropian për të matur besimin ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik është marrë si një mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesve të besimit për sektorë të veçantë ekonomikë (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

⁷ Punimet e specializuara të ndërtimit janë një kategori e re që EShS filloi të publikojë nga maji 2024 në kuadër të të dhënave për punimet e përfunduara të ndërtimit për muajin prill, dhe përfshin kategoritë "prishje dhe përgatitja e kantierit", "instalimet elektrike, hidraulike dhe të ujërave të zezë dhe punime të tjera ndërtimore", "Punime hidraulike", "punime përfundimi në ndërtim" dhe "punë të tjera të specializuara ndërtimi".

PRODIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	pri.	maj
	ndryshime reale vjetore në %										
Produkti i brendshëm bruto	1.7	4.0	1.8	1.5	1.4	0.9	1.0	0.9	1.2	-	-
Prodhimi industrial	3.5	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.7	0.4	-3.0	-1.2	-13.2
Punë ndërtimore të realizuara	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	46.6	-
Ndërtim i lartë	-26.6	12.4	-10.0	6.2	12.2	-20.0	-9.8	-18.3	-34.0	41.4	-
Ndërtim i ulët	4.2	-13.4	-26.9	-27.2	10.5	-22.6	-7.2	37.1	31.6	43.6	-
Punë ndërtimore të specializuara	-27.3	-55.3	-21.9	43.5	69.0	10.6	-21.2	11.3	-3.3	170.6	-
Qarkullimi në tregti - Gjithsej*	-11.7	-16.7	-17.4	-23.7	-11.1	-8.4	-7.3	-2.2	-8.6	-1.2	-2.1
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	-10.5	-14.9	-16.5	-21.3	-14.0	-11.7	-13.0	-4.1	-9.6	-2.9	-0.9
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	-14.7	-20.4	-19.3	-28.4	-4.8	-2.0	4.3	1.4	-6.5	1.4	-2.2

*Normat reale të rritjes janë përlogaritje nga BPRMV-ja, duke përfshirë normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 janë të dhëna preliminare. Të dhënat e PBB-së për vitin 2022 janë preliminare, ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 janë të vlerësuara.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.


Ndryshime më të favorshme vërehen edhe në **qarkullimin e përgjithshëm të tregtisë**, në mënyrë që në periudhën prill-maj rënia reale në bazë vjetore të ngadalësohet ndjeshëm...

...në kushte të rënies së ngadaltë në të tre llojet e tregtisë (tregti me pakicë, tregti me shumicë dhe tregtim automjetesh).


Në periudhën prill-maj thellohet rënia reale e prodhimit industrial në bazë vjetore...

...kryesisht për shkak të arritjeve më të dobëta në industrinë përpunuese (përkeqësim më i madh është në prodhimin e produkteve të gomës dhe produkteve nga masa plastike, prodhimin e makinerive dhe pajisjeve, prodhimin e tekstilit dhe prodhimin e mobiljeve).

Treguesit e veprimtarisë hotelierike
(ndryshimet reale vjetore)



Treguesit e lëvizjes së konsumit privat
(normat reale vjetore, në %)




Treguesit e disponueshëm për lëvizjen e **agregate** gjithashtu flet për lëvizje më të favorshme në ekonomi në tremujorin e dytë.

Të dhënat e disponueshme për lëvizjet e **konsumit personal** për periudhën prill-maj 2024 tregojnë kryesisht për rritje të mëtjshme të tij...

...me rritje të pagave, pensione, kredive për popullsinë, importit të mallrave të konsumit dhe të ardhurave bruto nga TVSH-ja. Në të kundërt, një rënie reale e mëtjshme, por më e vogël vërehet në tregtinë me pakicë, si dhe një ngadalësim i lehtë i rënies vërehet edhe në prodhimin vendas të mallrave të konsumit.

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.


Në lidhje me të dhënat me frekuencë të lartë për **investimet bruto** për periudhën prill-maj 2024, lëvizjet janë gjithashtu kryesisht në drejtim rritës...

...me rritje të punimeve të përfunduara të ndërtimit, importit të kapitalit qarkullues, prodhimit vendas të mallrave kapitale, stoqeve të produkteve të gatshme, tatim fitimit dhe mbështetjes kreditore të ndërmarrjeve...

...ndërsa rënie është vërejtur në investimet kapitale të qeverisë për shkak të bazës së lartë krahasuese, lidhur me paradhëniet për projekte infrastrukturore vitin e kaluar, si dhe rënie më të madhe është vërejtur edhe në totalin e prodhimit industrial.


Të dhënat për **shkëmbimin tregtar të jashtëm** për periudhën prill-maj 2024 tregojnë për një rritje të mundshme të deficitit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me rënie nominale të eksporteve dhe rritje të importeve të mallrave.

Arritjet buxhetore sipas të dhënave fiskale për periudhën prill-maj 2024 tregojnë për një rritje reale vjetore të **konsumit publik**.



Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në periudhën prill - maj 2024 u rrit me 44,2% me bazë vjetore, nën ndikimin e rënies së eksporteve dhe rritjes së njëkohshme të importit të mallrave.


Eksportet e mallrave në muajt prill - maj 2024 shënuan një rënie prej 8,1% në bazë vjetore, më së shumti si pasojë e uljes së eksporteve nga industria e automobilave, por edhe për shkak të hekurit dhe çelikut, tekstileve dhe energjisë. Arritjet në eksport janë aktualisht më të ulëta se sa pritej sipas projeksionit të prillit.



Importi i mallrave në muajt prill - maj 2024 shënoi një rritje prej 3,6% në bazë vjetore, për të cilën kontribuoi më shumë importi më i lartë i pajisjeve dhe makinerive, si dhe importi më i lartë i ushqimeve dhe automjeteve. Krahasuar me projeksionin e prillit, edhe realizimet e importeve janë më të ulëta në raport me projeksionin e prillit.


Deficiti tregtar në prill - maj 2024 është aktualisht në pajtim me pritjet për tremujorin e dytë të vitit, sipas projeksionit të prillit.

KREK (kursi real efektiv i këmbimit)
normat vjetore të ndryshimit, në %




Burimi: BPRMV.

KNEK (kursi nominal efektiv i këmbimit) dhe çmimet relative
normat vjetore të ndryshimit, në %




Burimi: BPRMV.

KREK, duke përjashtuar lëndët e para
normat vjetore të ndryshimit, në %



Burimi: BPRMV.

Lëvizjet e tregut të këmbimit




Burimi: BPRMV.

Në maj të vitit 2024, indekset e REDK shënuan një mbiçmim në baza vjetore, të ndikuar nga mbiçmimi i NEDC (kryesisht për shkak të zhvlerësimit të lirës turke dhe rubla ruse kundrejt denarit), ndërsa kostoja relative e jetesës dhe çmimet relative të produktet industriale ranë...

... ndërsa lëvizje të ngjashme janë regjistruar në indekset e REDK të llogaritura pa produktet primare


Blerja neto e realizuar në tregun valutor i realizuar në tremujorin e dytë të vitit 2024 tregon realizime pak më të ulëta në transfertat private se sa pritej për tremujorin e dytë, sipas projeksionit të prillit.

Rezervat devizore bruto
(gjendja në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Faktorët e ndryshimit të rezervave devizore në tr.2 2024
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV.

Tregu valutor
(në milionë euro)



Burimi: BPRMV.

Struktura e tregut valutor
(shitje/blerje neto, në milionë euro)



Burimi: BPRMV.


Rezervat valutore bruto në fund të qershorit 2024 kapin vlerën 4.337,5 milionë euro dhe shënojnë rritje krahasuar me fundin e tremujorit të parë, e cila më së shumti vjen si pasojë e transaksioneve të tjera në menaxhimin e rezervave valutore, si dhe e blerjes së realizuar gjatë ndërhyrjes së Bankës Popullore në tregun valutor.

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, tregu valutor i bankave regjistroi shitje neto të valutës, e cila është më e ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në kushtet e rritjes së ofertës për valutë dhe rënies së njëkohshme të kërkesës.


Nga analiza sektoriale rezulton se lëvizje të tilla në tregun valutor në tërësinë e tyre vijnë si pasojë e uljes së shitjeve neto të kompanive në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Instrumentet monetare

(gjendja në fund të muajit, në milionë denarë)



(gjendja në fund të vitit, në milionë denarë)



Burimi: BPRMV

Gjendja e instrumenteve monetare në fund të muajit qershor 2024 tregon një rënie të lehtë krahasuar me muajin paraprak, e cila vjen si pasojë e sasisë më të vogël të mjeteve bankare të vendosura në depozita të disponueshme pranë Bankës Popullore.

Gjendja e instrumenteve monetare në fund të qershorit 2024 tregon një rënie të lehtë krahasuar me muajin paraprak, e cila vjen si pasojë e sasisë më të vogël të mjeteve bankare të vendosura në depozita të disponueshme pranë Bankës Popullore.

Realizimet e parasë primare në fund të qershorit janë pak nën vlerat e parashikuara sipas projeksionit të prillit, për shkak të uljes së rezervave totale të bankave në Bankën Popullore.

Gjithsej depozitat⁸ në sistemin financiar në qershor të vitit 2024 shënoi një rritje mujore prej 0,3%. Nga pikëpamja sektoriale, rritja vjen nga depozitat e ndërmarrjeve, ndërsa **nga aspekti valutor** më i madh është kontributi i depozitave në denarë (me para depozituese).


Gjithsej depozitat gjatë tremujorit të dytë 2024 shënuan rritje krahasuar me tremujorin e parë, që është më i ulët se rritja e pritur për tremujorin e dytë të vitit sipas projeksionit të prillit.

Shkalla vjetore e rritjes së gjithsej depozitave në qershor të vitit 2024 është 7,6% dhe është nën shkallën e parashikuar për tremujorin e dytë 2024 prej 9, 2%, sipas projeksionit të prillit.


⁸ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshjetëror në banka dhe kursimore, aktivet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë në BPRMV dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në llogaritë në BPRMV. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV nga qershori 2018. Më shumë informacion rreth ndryshimeve metodologjike mund të gjeni në linkun e mëposhtëm: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspix.

Gjithsej depozitat

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




- Depozitat e sektorëve të tjerë
- Depozitat në denarë
- Depozitat në valutë të huaj
- Para të depozituara

* Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozitat e institucioneve të tjera financiare, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërve tek bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve të tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale tek Banka Popullore.


Në qershor të vitit 2024, **depozitat e amvisërve thuhet se stagnojnë**, me rritje të depozitave në valutë dhe rënie të depozitave në monedhë vendase (përfshirë paratë e depozitave). Në bazë vjetore, depozitat e amvisërve në qershor 2024 shënuan rritje prej 8,9%.

Depozitat e individëve

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




- Para të depozituara
- Depozitat e individëve në valutë të huaj
- Depozitat afatshkurte të individëve
- Depozitat e individëve në denarë
- Depozitat afatgjate të individëve
- Depozitat e individëve, ndryshimet mujore/vjetore, në %

Burimi: BPRMV.


Rrjedhimisht, në muajin qershor vihet re një rritje minimale e ponderit të depozitave në valutë në strukturën valutore ndaj totalit të depozitave të amvisërve.

Depozitat në denarë dhe në devizë /totali i depozitave të individëve

(pjesëmarrja në fund të muajit, në %)




(pjesëmarrja në fund të vitit, në %)




* Totali i depozitave vetëm tek bankat dhe kursimoret.
Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë M4

(kontributet në p.p., ndryshime mujore)



(kontributet në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, në qershor të vitit 2024, arriti një rritje prej 0,5%, e cila rezulton nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve nga aspekti valutor dhe maturiteti.

Në bazë vjetore, paraja e gjerë monetare në qershor të vitit 2024 regjistroi një rritje prej 7,6%, që është nën rritjen e pritshme vjetore prej 9,0% për tremujorin e dytë 2024, sipas projeksionit të prillit.


Pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në denarë në totalin e M4

(të dhënat në fund të muajit, në %)



Pjesëmarrja e pjesës në denarë në ofertën e përgjithshme monetare M4 në qershor të vitit 2024 është i ngjashëm me një muaj më parë dhe është në nivelin e vlerës së parashikuar për fund të tremujorit të dytë të vitit.


(të dhënat në fund të vitit, në %)



Burimi: BPRMV

Gjithsej kreditë


(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



Totali i kredive në qershor shënoi rritje mujore prej 0,8%

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024, kredia totale ka shënuar rritje krahasuar me tremujorin e parë, e cila është pak më e lartë se sa pritej për tremujorin e dytë të vitit sipas projeksionit të prillit.


(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Shkalla vjetore e rritjes së totalit të kredive në qershor ishte 6,4%, me një rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e dytë 2024 prej 6,0%.


Burimi: BPRMV.

**Kredi të reja të sektorit privat, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**




Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, në muajin maj, vijon të rritet me bazë vjetore, por me ritme më të ngadalta, si rezultat i të dy llojeve të kredive të sektorit (sipërmarrje dhe amvisërive).

**Kredi të reja të amvisërive, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**



**Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**




**Raporti ndërmejt kredive dhe depozitave totale
(të dhënat mujore, në %)**




Treguesi i shfrytëzimit të potencialit depozitues të bankave për kreditimin e sektorit privat në qershor është 83,1%, dhe është mbi vlerën e këtij treguesi të parashikuar në fund të tremujorit të dytë 2024, sipas projeksionit të prillit.

(të dhënat vjetore, në %)




Burimi: BPRMV

Normat e interesit të gjithsej depozitave
(të dhëna mujore, në %)




Normat e interesit të gjithsej kredive, sipas sektorëve
(të dhëna mujore, në %)



Burimi: BPRMV.

Në maj 2024, normat e interesit të kredive të **totalit dhe të miratuara rishtazi¹¹, kreditë për ndërmarrjet** shënoi rënie të lehtë krahasuar me muajin paraardhës, ndërkohë që normat e interesit për **kreditë totale dhe ato rishtazi të miratuara për amvisëritë** kanë mbetur të pandryshuara.

Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në %) dhe diferenca e tyre (në p.p)




Hapësira në normat bazë të interesit të Bankës Popullore dhe Bankës Qendrore Europiane ka shënuar një zgjerim të lehtë, duke qenë se Banka Qendrore Europiane uli normën bazë të interesit, pra normën e interesit të operacioneve bazë të rifinancimit¹².

¹¹ Për sa i përket normave të interesit të kredive rishtazi të miratuara, duhet pasur parasysh se ato karakterizohen nga lëvizje të ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për kreditë e miratuara rishtazi rrjedh nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të miratuara rishtazi (që mund të ndryshojnë nga muaji në muaj) dhe norma e tyre e interesit.

¹² Në të njëjtën kohë, BQE-ja theksoi se pavarësisht uljes me 0,25 p.p., me nivelin e ri të normave të interesit, shtrëngimi dhe kujdesi i politikës monetare vazhdon të ruhet.


Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

(kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)



Në muajin maj të vitit 2024, të hyrat në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve), shënojnë një rritje vjetore dukshëm më të ngadaltë, e cila është kryesisht për shkak të rritjes më të moderuar të të ardhurave nga të hyrat tatimore dhe kontributet, ndërsa shpenzimet buxhetore shënojnë rritje të lartë, e cila më së shumti rezulton nga kostot aktuale më të larta, në radhë të parë nga transfertat më të larta¹³.

Në periudhën janar – maj të vitit 2024, të hyrat totale buxhetore janë më të larta për 11,4% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa shpenzimet totale buxhetore janë më të larta për 14,5%.

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive,
(Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor


Deficiti buxhetor i realizuar në pesë muajt e parë në vlerë prej 20,545 milionë denarë paraqet 61,3% të deficitit të planifikuar për vitin 2024 në pajtim me buxhetin¹⁴...

¹³ Rritja e transfertave është pjesërisht si rezultat i pagesës nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të të drejtave nga mbrojtja sociale, fëmijërore dhe civile dhe pagesës së kompensimit arsimor për periudhën e tretë matëse për vitin shkollor 2023/2024.


¹⁴ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 283 nga viti 28.12.2023.

Financimi i bilancit buxhetor

(në milionë denarë)



... i njehti financohet kryesisht nga huamarrja neto e shtetit në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm, me rritjen e depozitave të shtetit në Bankën Popullore.




* Ndryshimi pozitiv: ulje e depozitave tek BPRMV, ndryshimi negativ: rritje e depozitave tek BPRMV.

Burimi: Ministria e Financave.

Normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore

në përqindje



Shtojca 1: Kategoritë treguese për konsumin personal dhe investimet bruto

KATEGORITË INDIKATIVE PËR KONSUMIN PRIVAT

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	pri.	maj
	<i>ndryshime reale vjetore në %</i>										
Qarkullimi në tregtinë me pakicë*	-10.5	-14.9	-16.5	-21.3	-14.0	-11.7	-13.0	-4.1	-9.6	-2.9	-0.9
Të ardhurat bruto nga TVSh-ja*	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	1.6	16.9	-0.7
Importi i mallrave për konsum të gjërë*	-2.8	-1.5	-2.1	-9.9	2.0	4.7	1.4	14.5	15.4	28.6	-9.2
Prodhimi vendor i mallrave të konsumit	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-8.5	1.1	-16.3
Kreditë konsumatore*	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	2.9	3.0	2.6
Paga mesatare neto*	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	12.5	9.3	-
Transferrat private neto*	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.6	-12.1	-	-
Pensionet*	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	17.1	14.4	8.2

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET

	2022				2023				2024		
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	pri.	maj
	<i>ndryshimet reale vjetore në %, përveç IHD-ve ku ndryshimet reale janë në milionë denarë</i>										
Importi i mjeteve për punë*	6.9	5.6	10.9	-1.3	-3.9	-1.9	-5.5	3.0	10.9	27.7	-9.8
Punë ndërtimore të realizuara**	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	46.6	-
Prodhimi vendor i produkteve kapitale	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	10.6	17.2	-11.8
Investime kapitale shtetërore*	-16.4	25.0	-47.3	55.6	-6.8	313.0	29.1	-4.0	27.6	-87.2	33.7
Investime të huaja direkte***	9615.9	-6349.8	10625.0	262.3	1114.3	-2026.8	-8584.5	-1964.6	5320.2	-	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	2.8	6.0	4.3
Stoqet e produkteve të gatshme	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	9.3	5.8	-

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.

** normat reale të rritjes janë fituar duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve për ndërtimin e banesave të reja.

*** vlerat reale janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar vlerat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2023= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.